

UDHËZIM
Nr. 32, datë 15.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015,
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 55, “Kufizime të zbritjes së TVSH-së për disa furnizime”, bëhen këto shtesa:

i. Pas germës “c”, të pikës III, shtohet pika “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Fermat bujqësore dhe blegtorale, deri në 12%.”.

ii. Mbas paragrafit “Llogaritjet, për sa i përket aplikimit të normativave, bëhen dhe regjistrohen në librin e blerjes. Kufizimet e tjera të së drejtës së zbritjes së TVSH-së aplikohen sipas nenit 74 të ligjit”, shtohet paragrafi si vijon:

“Normativa e kreditimit, për fermat bujqësore dhe blegtorale, të cilat janë përfituese nga skema kombëtare e mbështetjes, do të llogaritet vetëm për litrat shtesë.

Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve, kontrollit të tyre dhe njohja e kreditimit, kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT-ja në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ervin Meta

Botuar ne F.Zyrtare 184 / 2023

Dale nga shtypi me 19.12.2023